



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2020:154312

Datë: 30.11.2020

Numri i dokumentit: 01306951

**P.nr.1016/16**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENAL**, si gjykatë e shkallës së parë penale, e përbërë me gjyqtaren e vetme gjykuese Hakile Ilazi, me procesmbajtësin Gazmend Bytyqi, zyrtarin ligjor, në çështjen penale kundër të pandehurit A.K. nga fshati ...., Komuna Suharekë, për shkak të veprës penale në vazhdim vjedhje e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1108-6/16 të datës 24.10.2016, PP/II.nr.1004-4/16 të datës 29.05.2017, PP/II.nr.2261-4/16 të datës 06.11.2017, PP/II.nr.830-1/17 të datës 24.05.2017, PP/II.nr.1039-5/16 të datës 27.04.2017, PP/II.nr.72-7/17 të datës 07.02.2017, PP/II.nr.46-1/17 të datës 26.01.2017 dhe PP/II.nr.1020-5/18 të datës 26.06.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik në praninë e prokurorit të shtetit Mimoza Sylja-Hyseni, përfaqësuesit juridik te te dëmtuarës DBP në Ferizaj, Lumni Salihu, si dhe të pandehurit A.K. me datën 30.10.2020 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datën 30.11.2020 përpiloi me shkrim këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:** A.K. i lindur me datë ....nga i ati .... dhe nena .... e vajzërisë ....., me vendbanim në fshatin .... Komuna Suhareke, ka te kryer shkollën fillore, i papune, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mban nr. personal .....

### **ËSHTË FAJTOR**

1. Se me datën 04.06.2016, rreth orës 16:40, në rajonin ekonomiko-pyjor Nerodime-Jezercë, në vendin e quajtur “Ngastra 27”, me qëllim të vjedhjes me sharrë motorike

- ka prerë gjashtë /6/ copë dru të llojit te ahut, me dimensione te gjata-boniteti III, me diametër 20-50cm, me vëllim të përgjithshëm prej 7.14 m<sup>3</sup>, me c'rast i ka transportuar me traktor te tipit "Rakovica", duke i shkaktuar dëm Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari ne Ferizaj, në vlerë prej 966.24 Euro.
2. Se me datën 24.05.2016, rreth orës 15:10, në rajonin ekonomikopyjor Nerodime-Jezercë, në vendin e quajtur "Kroni i Hasan Mases", me qëllim vjedhje dhe shitje, me sharrë motorike ka prerë pesë /5/ copë dru të llojit te ahut, me diametër 27-68 cm, ne lartësi prej boniteti III, me vëllim të përgjithshëm prej 80.06 m<sup>3</sup>, duke i shkaktuar dëm Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari ne Ferizaj, në vlerë prej 1101.78 Euro.
  3. Se me datën 21.11.2016, rreth orës 12:08, në rajonin ekonomikopyjor Nerodime-Jezercë, në vendin e quajtur "Te varret e Krushqive", me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë një /1/ dru të llojit te ahut, me diametër 83 cm, ne lartësi prej boniteti III, me vëllim të përgjithshëm prej 10 m<sup>3</sup>, me c'rast i ka transportuar me krab "Rakovica",duke i shkaktuar dëm Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari ne Ferizaj, në vlerë prej 1.350.00 Euro.
  4. Se me datën 11.05.2017, rreth orës 14:30, në rajonin ekonomikopyjor Nerodime-Jezercë, në vendin e quajtur "Paralelja 60", me qëllim vjedhje ka prerë tre /3/ cope trungje të llojit te ahut, me diametër 40-50 cm, ne lartësi prej boniteti III, me vëllim të përgjithshëm prej 5.25 m<sup>3</sup>, duke i shkaktuar dëm Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari ne Ferizaj, në vlerë prej 708.75 Euro.
  5. Se me datën 26.05.2016, rreth orës 15:28, në rajonin ekonomikopyjor Nerodime-Jezercë, në vendin e quajtur "Te Kroni i Hasan Mazës", është takuar duke prerë tre /3/ copë trungje të llojit te ahut te cilat kane qene te prera me sharre motorrike, me dimensione te gjata-boniteti III, me diametër 48 cm, me vëllim të përgjithshëm prej 6.57 m<sup>3</sup>, me c'rast i ka transportuar me traktor te tipit "Rakovica", duke i shkaktuar dëm Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari ne Ferizaj, në vlerë prej 886.95 Euro.
  6. Se me datën 26.12.2016, rreth orës 13:30, në rajonin ekonomikopyjor Nerodime-Jezercë, në vendin e quajtur "Paralelja 60", me qëllim të vjedhje dhe shitje me

sharrë motorike ka prerë tetëdhjetë /80/ copë trungje të llojit te ahut, me dimensione te gjata-boniteti III, me diametër 20-15cm, me vëllim të përgjithshëm prej 10.40m<sup>3</sup>, duke i shkaktuar dëm Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari ne Ferizaj, në vlerë prej 1,591.20 Euro.

7. Se me datën 25.12.2016, rreth orës 11:50, në rajonin ekonomikopyjor Nerodime-Jezercë, në vendin e quajtur “Paralelja 38”, me qëllim të vjedhjes me sharrë motorike ka prerë njëzetë /20/ copë trungje të llojit te ahut, me dimensione te gjata-boniteti III, me diametër 18-14cm, me vëllim të përgjithshëm prej 2.20m<sup>3</sup>, duke i shkaktuar dëm Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari ne Ferizaj, në vlerë prej 336.60 Euro.
8. Se me datën 03.05.2018, rreth orës 10:30, në rajonin ekonomikopyjor Nerodime-Jezercë, në vendin e quajtur “Ngastra 28 Jezerc”, me qëllim të vjedhjes me sharrë motorike ka prerë pesë /5/ copë dru të llojit te ahut te njomë, me dimensione te gjata-boniteti III, me diametër 24-37cm, me vëllim të përgjithshëm prej 2.18 m<sup>3</sup>, me c’rast i ka transportuar me traktor te tipit “Rakovica 65” dhe rimorkio, duke i shkaktuar dëm Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari ne Ferizaj, në vlerë prej 319.32 Euro.

**me çka ka kryer veprën penale në vazhdim vjedhja e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 46, 50, 51, 52, 73, 74, 81 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin A.K., e

### **GJYKON**

- Dënim me gjobë në lartësi prej 800 Euro /tetëqind Euro/, të cilin gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Dhe

- Dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 /një/ Viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 2 /dy/ vite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në qoftë se i pandehuri gjatë kësaj kohe nuk do të kryej vepër të re penale.

- Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.
- Obligohet i akuzuari që në emër të kërkesës pasurore juridike, DBP-së Zyra në Ferizaj, t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në secilin pikë të dispozitivëve si në vijim: për pikën një shumën 966.24 Euro, për pikën dy shumën 1101.78 Euro, për pikën tre shumën 1350.00 Euro, për pikën katër shumën 708.75 Euro, për pikën pese shumën 886.95 Euro, për pikën gjashte shumën 1591.20Euro, për pikën shtatë shumën 366.60Euro si dhe për pikën tete shumën 319.32 Euro, të gjitha në afat prej 3 muaj, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit nën kërcënimin të përmbarimit me dhunë.
- Obligohet i akuzuari që konform nenit 450 par. 3 të KPPK-së, në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën 30 Euro /tridhjetë/, në afat prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me Aktakuzat PP/II.nr.1108-6/16 të datës 24.10.2016, PP/II.nr.1004-4/16 të datës 29.05.2017, PP/II.nr.2261-4/16 të datës 06.11.2017, PP/II.nr.830-1/17 të datës 24.05.2017, PP/II.nr.1039-5/16 të datës 27.04.2017, PP/II.nr.72-7/17 të datës 07.02.2017, PP/II.nr.46-1/17 të datës 26.01.2017 dhe PP/II.nr.1020-5/18 të datës 26.06.2018, ka ngarkuar të pandehurin A.K. nga fshati ....., Komuna Suhareke, për tetë /8/ vepra penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj, pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është ne juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është ne kompetencën lëndore dhe territoriale te

kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues.

Gjykata Themelore në Ferizaj, konform nenit 35 par. 1 dhe 8 të KPPR-së, sipas detyrës zyrtare si dhe propozimit të palëve në procedure, ka marrë Aktvendimin për bashkimin e procedurave penale sipas numrit të lëndëve të evidentuara në këtë gjykatë P.nr.1016/16, P.nr.1337/17, P.nr.309/17, P.nr.1031/17, P.nr.2771/17, P.nr.1296/17, P.nr.238/17 dhe P.nr.914/18, kundër të akuzuarit A.K., për shkak të tetë /8/ veprave penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 të KPRK-së, pasi që objekti i akuzës është i njëjtë, i dëmtuari i njëjtë dhe kryesi i njëjtë i veprës penale, si dhe për shkak te parimit te ekonomizimit të shpenzimeve të procedurës, gjykata me aktvendim të veçantë ka bashkuar lëndët e sipercékura, ndërsa ne vijim te procedurës te njëjtët do të udhëhiqen dhe evidentohet sipas nr. bazë P.nr.1016/16.

Në shqyrtimin gjyqësor, prokurori i shtetit Mimoza Sylja-Hyseni deklaroi se: bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës ne si prokuror i kësaj çështje, konform nenit 77 par.1 nenpar.1.1 dhe 1.5 lidhur me nenin 4 të KPRK-së, vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa vepra penale të njëjta ose të ngjashme të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes dhe të cilat paraqesin tërësi e ekzistimit të së paku dy kushteve si në vijim: viktimës së njëjtë të veprës penale, objekti i njëjtë i veprës penale, shfrytëzimi i situatës apo i marrëdhënies së njëjtë kohore, vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale si dhe dashja e njëjtë e kryesit, andaj duke pas parasysh faktet e sipër cekura bën rikualifikimin juridik të veprës penale edhe atë: nga tetë /8/ veprat penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-së, **në veprën penale vjedhja e pyllit në vazhdim nga neni 358 par.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së**, ndërsa sa i përket elementeve të veprës penale është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri i ka kryer veprat penale nga provat e paraqitura si dhe nga vet fakti se i pandehuri nuk i mohon veprimet qe i ka ndërmarrë në realizimin e këtyre veprave penale dhe po ashtu i propozoi gjykate që te njëjtin ta shpallë fajtor dhe t'i shqiptoj sanksion penal në pajtim me ligjin.

I pandehuri A.K. në shqyrtimin fillestar, me rastin e njoftimit nga gjyqtarja e vetme gjykuese për të drejtën e tij që të pranojë fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 246 të KPPK-së, i pandehuri deklaroi: *e pranoj fajësinë për veprën penale vjedhje pylli në vazhdim nga neni 358 par.2 të KPRK-së, sipas të gjitha pikave të aktakuzave, pranimin e fajësisë e bën në mënyrë vullnetare dhe është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë,*

*me tej shton se është i penduar dhe shpreh keqardhje për këtë vepër penale, është i gjendjes se rende ekonomike, i pa punësuar, jam mbajtës i familjes, premtom se ne te ardhmen nuk do te përsërisë vepër tjetër penale si dhe nga gjykata kërkon t'i shqiptoj një dënim sa më të butë.*

Prokurori i shtetit Mimoza Sylja-Hyseni, duke shprehur mendimin e saj përkitazi me pranimin e fajësisë, ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe një pranim i tille është bere konform dispozitave ligjore nga neni 248 te KPRK-se, pranimi i fajësisë është bere ne mënyrë vullnetare dhe ka mbështetje ne te gjitha provat dhe shkresat qe përmban aktakuza, duke i propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënim te parapare me ligjin.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPPRK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lendes siç janë: procesverbalet me nr. 270/16, 12/17, 33/17, 241/16, 664/16, 239/16, 05./17, dhe 164/18 te dt. 29.06.2016, fletëparaqitje e rojës se pyllit e dt. 29.06.2016, 05.01.2017, 15.05.2017, 15.06.2016, 24.11.2016, 16.06.2016, 13.01.2017 dhe dt.14.05.2018.
- si dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabim faktik.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtarja e vetme gjykuese konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik te Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhje pylli në vazhdim nga neni 358 par. 2 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi, të përshkruar me datën, vendin, kohën dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë në seancën fillestare, gjendjen e rende ekonomike dhe faktin se i akuzuari është penduar thellë për veprën penale. Ndërsa rrethane rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave të pandehurit i vërtetoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi me bindjen se në rastin konkret me dënimin e tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet paushall është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P.nr.1016/16, te datë 30.11.2020**

**Zyrtar ligjor:**  
**Gazmend Bytyqi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese:**  
**Hakile Ilazi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit KOSOVËS në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të kësaj gjykate.